



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 02/29

Datë: 15.05.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011 në mbledhjen e mbajtur më 15 maj 2015, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Koncept-dokumenti për rregullimin e të Drejtës Ndërkombëtare Private.
2. Obligohet Ministria e Drejtësisë dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Isa MUSTAFA**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria-Vlada-Government*  
*Ministria e Drejtësisë –Ministarstvo Pravde –Ministry of Justice*

---

**KONCEPT DOKUMENTI PËR**  
**RREGULLIMIN E TË SË DREJTËS NDËRKOMBËTARE**  
**PRIVATE**

## Kapitulli 1: Hyrje

Në kuadër të *Planit Vjetor të Punës së Qeverisë*, për vitin 2015, Pjesa e Ministrisë së Drejtësisë (*aktiviteti 1.14*) është paraparë hartimi i këtij koncept dokumentit për rregullimin e të drejtës ndërkombëtare private, në *Listën e Koncept Dokumenteve* pika nr. 19.

Rregullimi i kësaj fushe ndërlidhet me Planin vjetor të punës së Qeverisë, respektivisht me *Prioritetin Strategjik nr.2 Qeverisja e mirë dhe fuqizimi i sundimit të ligjit dhe shtetit të së drejtës*.

Në kuadër të Planit Zhvillimor Strategjik 2012 – 2016 të Ministrisë së Drejtësisë, është e përcaktuar në objektivin e parë, avancimi i kornizës ligjore dhe institucionale në funksion të sundimit të rendit dhe ligjit në pajtueshmëri ligjore me prioritetet që dalin nga procesi i integritimit evropian.

Qeveria respektivisht Ministria e Drejtësisë konsideron prioritare rregullimin e kësaj fushe duke marrë parasysh faktin se në fushën e të drejtës ndërkombëtare private aktualisht është duke u aplikuar legjislacioni i ish RSFJ, përkatësisht *Ligjin për Zgjidhjen e Kolizionit të Ligjeve* me dispozitat e shteteve tjera në marrëdhëniet e caktuara, vështirësitë e identifikuar në zbatim nga institucionet përkatëse të Republikës së Kosovës në njohjen e vendimeve të organeve të huaja, koherencën me legjislacionin aktual në fuqi dhe kërkesat e shumta të qytetarëve të Kosovës për njohjen e këtyre vendimeve.

## Kapitulli 2: Përshkrimi dhe definimi i çështjes/problemit kryesor

### *Shpjegim*

Fusha e të drejtës ndërkombëtare private ka qenë pjesë e sistemit juridik të ish-RSFJ në kuadër të së cilës ka qenë edhe Kosova. Kjo fushe është rregulluar me Ligjin aktual për zgjidhjen e kolizionit të ligjeve me dispozitat e vendeve tjera në marrëdhënie të caktuara (*Fletorja Zyrtare e RSFJ, Nr. 43/82 dhe 78/822*). Ky ligj përmban rregulla mbi kompetencën e gjykatave për shqyrtimin e marrëdhënieve të cekura me lartë, rregulla për procedurën dhe rregulla për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja gjyqësore dhe vendimeve të organeve të tjera të shtetit të huaj.

Ligji për zgjidhjen e kolizionit të ligjeve me dispozitat e vendeve tjera në marrëdhënie të caktuara (*Fletorja Zyrtare e RSFJ, Nr. 43/82 dhe 78/822*) nuk ka gjetur zbatim funksional në praktik me ndryshimin e rrethanave politike, ekonomike, juridike në Republikën e Kosovës.

Parimi i reciprocitetit, i ekonomizimit të procedurës dhe i bashkëpunimit juridik ndërkombëtar janë arsye kryesore që shtetet të pranojnë që gjykatat e tyre ti marrin parasysh vendimet e huaja gjyqësore dhe te organeve tjera kompetente, për ti njohur apo zbatuar në territorin e tyre.

Nga fusha e të drejtës ndërkombëtare private të ndikohen gjykatat dhe organet e tjera kompetente të cilat zbatojnë dispozitat e Ligjit për zgjidhjen e kolizionit të ligjeve me dispozitat e vendeve tjera në marrëdhënie të caktuara, të caktuara sipas Ligjit për Gjykatat Nr. 03/L-199, në nenin 11 paragrafin 2 të këtij ligji parashihet se Gjykatat Themelore janë kompetente për të dhënë ndihmë juridike ndërkombëtare dhe për të vendosur lidhur me pranimin apo njohjen e vendimeve të gjykatave të huaja. Të ndikuar janë edhe mërgimtarët apo pjesëtarët e diasporës dhe mërgatës, që kanë të bëjnë me zgjidhje në çështjet statusore, familjare, marrëdhënie të punës, pronësore dhe marrëdhënie tjera materialo -juridike.

Kjo fushë ka karakter gjithëpërfshirës dhe prek tërë territorin e Republikës së Kosovës, për faktin që secila Gjykatë Themelore për territorin e vet është kompetente për dhënie të ndihmës juridike ndërkombëtare dhe njohjen e vendimeve të huaja.

Në Kosovë janë gjithsej shtatë (7) Gjykata Themelore: Gjykata Themelore në Prishtinë, Ferizaj, Gjilan, Prizren, Gjakovë, Pejë dhe Mitrovicë.

Në Ministrinë e Drejtësisë, Departamentin për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar (DBJN)(*të dhënat janë ofruar për vitin 2013 dhe 2014*), ndërsa në Gjykatat Themelore të Kosovës janë proceduar dhe shqyrtuar një numër i lëndëve me element të huaj, ku statistikat për vitin 2013 dhe për periudhën janar- shtator 2014 tregojnë, si në vijim:

Institucioni	Viti 2013-nr. i rasteve	Viti 2014-nr. i rasteve
Ministria e Drejtësisë (DBJN)	2660	2222
Gjykata Themelore Prishtinë	398	248
Gjykata Themelore Gjakovë	58	69
Gjykata Themelore Gjilan	315	249
Gjykata Themelore Pejë	138	62
Gjykata Themelore Prizren	126	95
Gjykata Themelore Mitrovicë	51	62
Gjykata Themelore Ferizaj	56	71

Me këtë propozim në mënyrë indirekte janë të prekura edhe institucionet e mëposhtme:

- Ministria e Punëve të Jashtme (Misionet Diplomatike),
- Ministria e Punëve të Brendshme,
- Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale,
- Ministria e Diasporës, etj.

### *Informata*

Ligji për zgjidhjen e kolizionit të ligjeve me dispozitat e vendeve tjera në marrëdhënie të caktuara (Fletorja Zyrtare e RSFJ, numër 43/82 dhe 78/822) i cili mbulon këtë fushë përmban rregulla për kompetencën e gjykatave dhe organeve të tjera të Republikës së Kosovës, rregulla për procedurën dhe rregulla për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja gjyqësore dhe vendimeve të organeve të tjera të shtetit të huaj.

Që nga hyrja në fuqi e ligjeve të reja të gjyqësorit, ekzistojnë vështirësi në zbatimin praktik të dispozitave në legjislacionin aktual i cili parasheh organe komplet të ndryshme nga ato që funksionojnë tani sipas ri-organizimit të ri. Prandaj gjendja aktuale nuk është shumë e sqaruar dhe herë-herë ka edhe konfuzione me ligjin aktual, lidhur me njohjen e vendimeve të huaja që lëshohen nga organet tjera kompetente administrative apo publike të shteteve të huaja, pasi që në praktik janë paraqitur raste kur qytetarët tanë kanë paraqitur kërkesë në gjykatë për njohjen e vendimit të organit të shtetit të huaja. (Rasti me Norvegjinë, ku sipas ligjit të shtetit Norvegjez, zgjidhjen e martesës me marrëveshje e bënë organi administrative-Prefektura).

Me hyrjen në fuqi të Ligjit për Gjykata, pushteti gjyqësor ushtrohet nga Gjykata Themelore, Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme. Ky ligj nuk parasheh Gjykatën Ekonomike siç ka qenë me ligjin e mëparshëm, tani kemi vetëm Departamentin për Çështje Ekonomike që vepron në kuadër të Gjykatës Themelore në Prishtinë.

Kontestet ndërmjet bizneseve të dy shteteve të ndryshme, një biznesi nga Kosova dhe një biznesi të shtetit të huaj, njohjen e vendimeve të huaja të arbitrazhit e bënë Departamenti ekonomik i Gjykatës Themelore në Prishtinë, ndërsa ekzekutimin e këtyre vendimeve e bëjnë përmbaruesit privat. Departamenti ekonomik funksionon vetëm në Gjykatën Themelore në Prishtinë për tërë territorin e Republikës së Kosovës, prandaj edhe dispozitat e ligjit i cili e mbulon këtë fushë duhet të jenë në harmoni me ndryshimet e legjislacionit për sistemin gjyqësorë të cilat janë në fuqi dhe duke u zbatuar nga viti 2012.

Kohëve të fundit në Gjykatat e Republikës së Kosovës janë paraqitur disa kërkesa për njohjen e vendimeve të gjykatave të huaja lidhur me adoptimin në rastet kur në shtetet e huaja janë adoptuar fëmijët kosovar të cilët kanë mbushur moshën madhore. Këto vendime po refuzohen për tu njohur nga Gjykatat e Republikës së Kosovës me arsyetim se fëmija i moshës madhore sipas Ligjit të Familjes në Kosovë nuk mundë të adoptohet. (Rastet nga Gjermania dhe Austria).

### *Politika aktuale*

Kjo fushë aktualisht është rregulluar me Ligjin për zgjedhjen e kolizionit të ligjeve me dispozitat e vendeve tjera në marrëdhëniet e caktuara (Fletorja Zyrtare e RSFJ, numër 43/82 dhe 78/822).

Me këtë ligj është rregulluar caktimi i të drejtës kompetente për marrëdhëniet kontraktuale dhe jashtë kontraktuale me element ndërkombëtar.

Po ashtu ligji rregullon të drejtën kompetente për rregullimin e marrëdhënieve personale - statusore, marrëdhëniet pronësore - juridike, marrëdhëniet familjare me element ndërkombëtar.

Gjithashtu, Ligji rregullon kompetencën e Gjykatave dhe organeve tjera në çështjet me element ndërkombëtar, përmban rregulla për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja gjyqësore dhe organeve tjera kompetente. Përgjegjëse për zbatimin e këtij ligji janë Gjykatat e Republikës së Kosovës dhe organet tjera administrative. Organet kompetente janë ballafaquar me mangësi dhe vështirësi gjatë zbatimit të këtij ligji kryesisht në njohjen e vendimeve të huaja mirëpo për rregullimin e kësaj çështje deri më tani nuk është marrë ndonjë veprim. Rregullativa e ligji nuk është koherente me gjendjen, nevojën dhe kërkesat aktuale të shoqërisë në këtë fushë.

### *Ligjet dhe aktet nënligjore*

Për rregullimin e fushës së të drejtës ndërkombëtare private, përveç Ligjit të aplikueshëm për zgjidhjen e kolizionit të ligjeve me dispozitat e vendeve të tjera në marrëdhënie të caktuara (*Fletorja Zyrtare e RSFJ, numër 43/82 dhe 78/822*); i cili mbulon këtë fushë, ligjet tjera ndikojnë në mënyrë të tërthortë në raport me këtë çështje.

**Ligji për Gjykatat (Nr.03/L-199)** - Ky ligj rregullon organizimin, funksionimin dhe juridiksionin e gjykatave në Republikën e Kosovës. Sipas këtij ligji Gjykatat Themelore janë kompetente për të dhënë ndihmë juridike ndërkombëtare dhe për të vendosur për pranimin e vendimeve të gjykatave të huaja;

**Ligji për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar në Çështjet Penale (Ligji Nr. 04/L-31)** Ky ligj rregullon kushtet dhe procedurat për dhënien e ndihmës juridike ndërkombëtare në çështjet penale, në qoftë se me marrëveshjen ndërkombëtare nuk është caktuar ndryshe apo nëse nuk ekziston marrëveshja ndërkombëtare. Në mungesë të një marrëveshje ndërkombëtare ndërmjet Kosovës dhe shtetit të huaj ndihma juridike ndërkombëtare mund të ofrohet mbi bazën e parimit të reciprocitetit.

**Ligji për Familjen i Kosovës (Ligji Nr.2004/32)**; ky ligj ndërlidhet me fushën e të drejtës ndërkombëtare private sepse me dispozitat e këtij ligji rregullojnë çështjet me element të huaj në marrëdhëniet familjare, si: fejesën, martesën marrëdhëniet ndërmjet

prindërve dhe fëmijëve, adoptimin (birësimin), kujdestarinë, mbrojtjen e fëmijëve pa përkujdesje prindërore, marrëdhëniet pasurore në familje dhe procedurat e posaçme të gjykatës përkitazi me kontestet lidhur me marrëdhëniet familjare.

**Ligji për Trashëgiminë i Kosovës (Ligji Nr. 2004/26);** rregullohen procedurat në bazë të të cilave gjykata, organet tjera dhe personat tjerë të autorizuar duhet të veprojnë në çështjet trashëgimore. Çështjet trashëgimore me element të huaj në këtë ligj përcaktohen me dispozita përkatëse ku trashëgimia e personave të huaj rregullohet nga ligjet të vendit qytetar i të cilit ka qenë trashëgimlënësi në kohën e vdekjes. Në qoftë se në shtetin e shtetasit të huaj të vdekur shqyrtohet pasuria trashëgimore e qytetarit të Republikës së Kosovës sipas ligjeve të tij, pasuria trashëgimore e këtij shtetasi të huaj që ndodhet në territorin e Republikës së Kosovës do të shqyrtohet sipas dispozitave të këtij ligji.

**Ligji për Procedurën Kontestimore (Ligji Nr. 03/L-006);** Me Ligjin për Procedurën Kontestimore caktohen rregulla procedurale në bazë të të cilave gjykata i shqyrton dhe i zgjidhë kontestet nga marrëdhëniet juridiko-civile në përputhje me standardet ndërkombëtare.

**Ligji për Procedurën Përmbarimore. (Ligji Nr. 04/L-139)** Ky ligj rregullon procedurën përmes së cilës Gjykatat dhe përmbaruesit privat përcaktojnë dhe zbatojnë përmbarimin në bazë të dokumenteve përmbarues dhe dokumenteve të besueshme, përveç nëse me ligj të veçantë parashihet ndryshe.

Përmbarimi i dokumentit të huaj përmbarimor do të caktohet dhe zbatohet sipas këtij ligji, nëse dokumenti përmbarimor i huaj i plotëson kushtet e parapara me ligj apo marrëveshje ndërkombëtare për pranim dhe përmbarim.

Në pasurinë e shtetit të huaj në Republikën e Kosovës ose të organizatës ndërkombëtare, e cila gjendet në territorin e Republikës së Kosovës, nuk mund të caktohet përmbarimi pa pëlqimin paraprak të Ministrit të Drejtësisë dhe mendimit të Ministrit të Punëve të Jashtme, përveç kur shteti i huaj apo organizata ndërkombëtare është pajtuar me përmbarimin. Nëse propozimi për fillimin e procedurës mbi pronën e shtetit të huaj në Republikën e Kosovës nuk është paraqitur pëlqimi nga përkatësisht pajtimin të shtetit të huaj, propozimin do ta hedhë poshtë përmbaruesi privat përkatësisht Gjykata

**Ligji për shtetësinë e Kosovës ( Nr.04/L-215 )** Me këtë ligj përcaktohen mënyrat efitimit, humbjes dhe rifitimit të shtetësisë së Republikës së Kosovës dhe rregullohen çështje të tjera të ndërlidhura me shtetësinë e Republikës së Kosovës.

**Ligji për të huajt( nr. 04/L-219)**Ky ligj rregullon kushtet e hyrjes, lëvizjes, qëndrimit dhe punësimit të të huajve në territorin e Republikës së Kosovës.

**Udhëzim Administrativ për Procedurën e ofrimit të Ndhmës Juridike Ndërkombëtare në çështjet Penale dhe Civile (Nr. 2009/1-09);** Ky Udhëzim Administrativ përcakton procedurën për ofrimin e ndihmës juridike ndërkombëtare në lëmin civile dhe penale dhe është i aplikueshëm për të gjitha kërkesat për ndihmë

ndërkombëtare që u adresohen shteteve të huaja dhe atyre që vijnë nga këto shtete për në Republikën e Kosovës.

### *Shpenzimet aktuale*

Kategoria e shpenzimeve	Shpenzimet faktike në vitin paraprak	Buxheti këtë vit	KASH për vitin e ardhshëm
Buxheti i Ministrisë: (shëno secilin lloj të shpenzimit)	Buxheti i DBJN-se 149,505.00	2015 211,186.00	2016 211,186.00
Buxhetet tjera: (shëno secilin lloj të shpenzimit)			
Financimi nga donatorët			
Shpenzimet e drejtpërdrejta nga Ministria e Financave			

### *Përvoja në shtetet tjera*

Në bazë të analizave të bëra lidhur me këtë çështje, shtetet e rajonit dhe ato të BE-së e kanë të rregulluar në mënyrë specifike fushën e lartpërmendur përmes legjislacionit përkatës. Nga shtetet e rajonit të cilat i kemi hulumtuar janë Maqedonia dhe Shqipëria, të cilat këtë fushë e kanë të rregulluar me ligje të veçanta, Maqedonia këtë fushë e ka të rregulluar me Ligjin për të drejtën ndërkombëtare të vitit 2007, ndërsa Shqipëria këtë fushë e ka të rregulluar me Ligjin Nr.10 428, të datës 2.6.2011 për të drejtën ndërkombëtare private, të cilat kanë rregulluar në mënyrë specifike të gjitha institutet e drejtës ndërkombëtare private, si caktimin e të drejtës kompetente për marrëdhëniet statusore, familjare e pronësore, marrëdhëniet materialo-juridike me element ndërkombëtar, si dhe kompetencën e gjykatave lidhur me njohjen dhe ekzekutimi i vendimeve të huaja gjyqësore dhe organeve tjera kompetente.

Në Bashkimin Evropian kjo fushë është e rregulluar me legjislacionin që bënë pjesë në kapitullin e drejtësisë, lirisë dhe sigurisë, dhe kjo pjesë poashtu është e rregulluar me Rregulloren nr. 593/2008e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, 17 Qershor 2008, mbi të drejtën kompetente për detyrimet kontraktuese që inkorporon Konventën e parë të



Romës; 2) Rregulloren nr. 864/2007e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, 11 Korrik 2007, mbi të drejtën kompetente për detyrimet jashtë kontraktuese, që inkorporon Konventën e dytë të Romës; 3) Rregulloren nr. 1215/2012e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, 12 Dhjetor 2012, mbi kompetencën dhe njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve gjyqësore në çështjet civile dhe komerciale, që inkorporon Konventën e parë të Brukselit; 4) Rregullorja nr. 2201/2003e Këshillit, 27 Nëntor 2003, lidhur me kompetencën dhe njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve gjyqësore në çështjet martesore dhe çështjet lidhur me përgjegjësinë prindërore, që inkorporon Konventën e dytë të Brukselit, e amenduar nga Rregullorja 2116/2004.

### **Kapitulli 3: Synimet dhe objektivat**

#### *Synimi*

Rregullimi i fushës së të drejtës ndërkombëtare private synon të rregulloj caktimin e të drejtës kompetente për marrëdhëniet statusore, familjare e pronësore, marrëdhëniet materialo-juridike me element ndërkombëtar. Po ashtu synim i rregullimi të kësaj fushe është të rregulloj çështjen e kompetencës së Gjykatave dhe organeve tjera të Republikës së Kosovës për shqyrtimin e marrëdhënieve materialo-juridike me element ndërkombëtar, rregullimin lidhur me njohjen dhe ekzekutimi i vendimeve të huaja gjyqësore dhe organeve tjera kompetente.

#### *Objektivat*

- Avancimin e bazës ligjore që rregullon fushën e të drejtës ndërkombëtare private;
- Ngritja e nivelit të bashkëpunimit ndër shtetëror që ndërlidhet me fushën e të drejtës ndërkombëtare private;
- Ngritja e koordinimit ndër institucional që ndërlidhet me fushën e të drejtës ndërkombëtare private.

## **Kapitulli 4: Opsionet**

### ***Opsioni 1: Opsioni status quo (asnjë ndryshim)***

Mos ndryshimi i politikës ekzistuese i cili mbulon këtë fushë me Ligjin për zgjidhjen e kolizionit të ligjeve me dispozitat e vendeve të tjera në marrëdhënie të caktuara (*Fletorja Zyrtare e RSFJ, numër 43/82 dhe 78/822*) problemet e nxjerra në pa nga analiza ligjore, do të pamundësojnë zbatimin në praktik lidhur me rregullat për caktimin e të drejtës kompetente për marrëdhëniet statusore, familjare pronësore, pikërisht marrëdhëniet tjera materialo-juridike me element ndërkombëtar, rregulla për kompetencën e gjykatave për procedurën dhe rregulla për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja gjyqësore dhe vendimeve të organeve të tjera të shtetit të huaj, në përputhje me nevojat reale të shoqërisë dhe standardet ndërkombëtare.

### ***Opsioni 2: Ndryshimi i politikës ekzistuese***

Rregullimi i kësaj çështje për të drejtën ndërkombëtare private do të bëhet duke hartuar një politikë të re respektivisht një ligj të ri ngaqë politika ekzistuese nuk është konform ndryshimeve që janë bërë, andaj është shumë e nevojshme që kjo fushë të ketë një ndryshim dhe avancim konform ndryshimeve që janë bërë në legjislacion dhe në marrëdhënie shoqërore. Hartimi i ligjit do të rregullon këtë fushë në harmoni me ndryshimet e legjislacionit në sistemin gjyqësor, rrethanave shoqërore dhe zbrazëtirave ligjore të identifikuar nga organet përgjegjëse që kanë zbatuar ligjin e aplikueshëm, lidhur me caktimin e të drejtës kompetente për marrëdhëniet kontraktuale dhe jashtë kontraktuale me element ndërkombëtar, të drejtën kompetente për rregullimin e marrëdhënieve personale – statusore, marrëdhëniet pronësore – juridike, marrëdhëniet familjare me element ndërkombëtar, gjithashtu rregullimin për kompetencën e Gjykatave dhe organeve tjera për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja gjyqësore dhe organeve tjera kompetente.

### ***Opsioni 3: Rregullimi i kësaj fushe me akte të brendshme të institucioneve përgjegjëse***

Mënyra tjera të trajtimit të kësaj çështjeje në rast të qëndrimit të ligjit aktual, do të jenë përmes rregullimit të kësaj çështjeje përmes nxjerrjes së akteve nënligjore të institucioneve veç e veç, përmes kësaj alternative do të ekzistonte një mundësi jo e unifikuar e rregullimit të kësaj fushe dhe jo konform nevojave e kërkesave aktuale të shoqërisë, kështu që ky problem do të krijonte pengesa dhe vështirësi të mëtejshme për këtë alternativë të rregullimit dhe zbatimit, pasi që kjo mënyrë e trajtimit do t'i jepte një

mundësi për të cilën bazueshmëria do të ishte e paqëndrueshme në legjislacionit e ish sistemit, i cili është totalisht i ndryshëm nga sistemi aktual.

Në rast të rregullimit përmes akteve të brendshme të kësaj fushe, përgjegjësia dhe baza juridike e referimit do të jetë përsëri e njëjtë të organeve të njëjta pasi që kjo përgjegjësi është shprehimisht e rregulluar me ligjin aktual.

## Kapitulli 5: Përmbledhje e opsioneve

Përmbledhje e Opsioneve			
Karakteristikat kryesore	Opsioni 1	Opsioni 2	Opsioni 3
Karakteristikat kryesore të opsionit	Status Quo	Ligji i ri i veçantë	n/a
Segmenti i popullsisë/ sektori/	Pjesëtarët e Diasporës	Pjesëtarët e Diasporës	Pjesëtarët e Diasporës
Karakteristikat e zbatimit – kush është përgjegjës – një resor i Qeverisë (cili), sektori privat, qytetarët	Gjykatat dhe Organet tjera kompetente	Gjykatat dhe Organet tjera kompetente	Gjykatat dhe Organet tjera kompetente
Administrimi ose zbatimi i programit ose shërbimit	Nuk është paraparë	Nuk është paraparë	Nuk është paraparë
Ligjet, aktet nënligjore, ndryshimet dhe plotësimet e ligjeve ekzistuese si dhe zbatimi dhe dënimet	Ligjin për zgjidhjen e kolizionit të ligjeve me dispozitat e vendeve të tjera në marrëdhënie të caktuara	Ligji i ri për të Drejtën Ndërkombëtare Private	Ligjin për zgjidhjen e kolizionit të ligjeve me dispozitat e vendeve të tjera në marrëdhënie të caktuara, dhe aktet nënligjore
Stimulimet ose mos-stimulimet ekonomike – subvencionet ose taksat	Nuk ka ndryshim	Nuk ka ndryshim	Nuk ka ndryshim
Fushatat e edukimit dhe komunikimit	Nuk ka ndryshim	Nuk janë paraparë	Nuk ka ndryshim
Udhëzimet dhe kodet	Nuk është paraparë	Nuk është paraparë	Përmes akteve nënligjore
Afatet kohore – kur hyn në fuqi opsioni	Është e aplikueshme politika aktuale	2015	2015

## Kapitulli 6: Analiza e opsioneve

### *Përfitimet*

**Opsioni 1** (*status quo*) edhe përkundër mangësive të nxjerra nga analiza ligjore ligji aktual megjithatë e mbulon fushën e të drejtës ndërkombëtare private. Nga analiza e eksperteve të kësaj fushe është konstatuar se nuk do ketë ndonjë përfitim eventual nga ky opsion pasi gjendja aktuale nuk është e rregulluar sipas ndryshimeve në rrethanat shoqërore.

**Opsioni 2.** Përmes hartimit të ligjit të ri - këtij opsioni do të rregulloheshin këto çështje: caktimin e të drejtës kompetente për marrëdhëniet kontraktuale dhe jashtë kontraktuale me element ndërkombëtar; caktimin e të drejtën kompetente për rregullimin e marrëdhënieve personale – statusore si shtetësinë, zotësinë juridike, zotësinë e veprimit, kujdestarinë, shpalljen e personit të zhdukur për të të vdekur dhe ndryshimin e emrit të personit fizik.

Hartimi i Ligjit të ri do të rregulloj marrëdhëniet pronësore – juridike; marrëdhëniet familjare me element ndërkombëtar si trashëgiminë, martesën, shkurorëzimin dhe marrëdhëniet në mes të prindërve dhe fëmijëve; caktimin e të drejtës kompetente në marrëdhëniet kontraktuale me element ndërkombëtar, veçanërisht te kontratat për sendet e paluajtshme, për punësim dhe për konsum; cedimi punët juridike aksesore, punët e njëanshme juridike, fitimi pa bazë dhe gjerimi i punëve të huaja.

Po ashtu ligji i ri do rregulloj edhe kompetencën e gjykatave dhe organeve tjera në çështjet me element ndërkombëtarë si dhe rregullat për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja gjyqësore dhe organeve tjera. Përfitim i drejtpërdrejtë do të jetë zbatimi i suksesshëm në praktik i rregullativës së marrëdhënieve të lartpërmendura.

**Opsioni 3.** Në rast të rregullimit përmes akteve të brendshme të kësaj fushe, përgjegjësia dhe baza juridike e referimit do të jetë përsëri e njëjtë të organeve të njëjta pasi që kjo përgjegjësi është shprehimisht e rregulluar me ligjin aktual.

### *Pasojat negative*

**Opsionit 1,** (*status quo*), gjegjësisht mbetja në fuqi të Ligjit aktual, do të ketë pasoja negative, pasi që do të vazhdonte zbatimi joefikas i këtij Ligji ngase rregullativa e tij

nuk është me kërkesat dhe nevojat aktuale të shoqërisë. Për më shumë ky opsion nuk është koherent me procesin e Integrimit Evropian, gjegjësisht me legjislacionin në fuqi.

**Opsioni 3**, Pasojat negative të këtij opsioni janë vështirësia e referimit tek dispozitat aktuale të cilat nuk përcaktojnë kompetencën e institucioneve të tanishme për rregullimin e marrëdhënieve të së drejtës ndërkombëtare private, pasi që kemi një strukturë së pari gjyqësore të ndryshme nga ajo e mëparshme, dhe poashtu mund të ketë konflikt të kompetencave midis institucioneve përgjegjëse si në rregullim poashtu edhe në implementim.

### *Kosto*

Politika jonë e propozuar është vlerësuar që zbatimi i kësaj politike nuk ka implikime financiare shtesë, ngase nuk do të krijohen institucione tjera, ndërsa sa i përket trajnimeve për organet ligjzbatuese, Instituti Gjyqësor i Kosovës (IGJK) është përgjegjës dhe ka ndarje buxhetore për ofrimin e trajnimeve, sipas IGJK për një ligj të tillë që nuk është voluminoz maksimumi mund të mbahen dy trajnime. Kostoja e përafërt vlerësohet të jetë 2000 euro nëse mbahet në IGJK dhe marrin pjesë 20 pjesëmarrës.

<b>Përmbledhje e Vlerësimit të Ndikimit Financiar</b>				
	(000 Euro)			
	Viti aktual	Viti 2	Viti 3	Viti 4
<b>Opsioni 1</b>	0	0	0	0
Diferenca neto në alokimin e shpenzimeve	0	0	0	0
Diferenca neto në gjenerimin e të hyrave	0	0	0	0
Financimi i pritur nga donatorët	0	0	0	0
<b>Opsioni 2</b>				
Diferenca neto në alokimin e shpenzimeve	0	0	0	0
Diferenca neto në gjenerimin e	0	0	0	0

të hyrave				
Financimi i pritur nga donatorët	0	0	0	0
<b>Opsioni 3</b>				
Diferenca neto në alokimin e shpenzimeve	0	0	0	0
Diferenca neto në gjenerimin e të hyrave	0	0	0	0
Financimi i pritur nga donatorët	0	0	0	0

## Kapitulli 7: Konsultimi

Për rregullimin e fushës së lartpërmendur konsultimet kanë filluar më herët dhe si rezultat i konsultimeve ka dalë konkluzioni se është e nevojshme që kjo fushë të rregullohet me hartimin e Ligjit të ri, i cili do të mbuloj këtë fushë.

Konsultimet janë bërë konform Nenit 7 të Rregullores së Punës së Qeverisë me ekspert të Drejtës Ndërkombëtare Private, profesor në Fakultetin Juridik, Këshillin Gjyqësor të Kosovës përkatësisht përfaqësues nga Gjykata Themelore, Instituti Gjyqësor i Kosovës përfaqësues nga Zyra e Kryeministrit, Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Departamenti për Bashkëpunim Ndërkombëtar Juridik në Ministrinë e Drejtësisë, dhe poashtu drafti i Koncept Dokumentit i është dërguar edhe OJQ-ve. Qëndrimi i këtyre institucioneve ishte i përbashkët se është e nevojshme që kjo fushë të rregullohet me hartimin e Ligjit të ri i cili e mbulon këtë fushë. Përfaqësues të institucioneve të lartpërmendura kanë marrë pjesë në hartimin e këtij Koncept Dokumenti dhe janë përfshirë propozimet e dhëna se ligji me të cilin mbulon këtë fushë të quhet Ligji për të Drejtën Ndërkombëtare Private i dhënë nga përfaqësues nga Zyra e Kryeministrit, propozime nga organet ligjzbatuese.

Gjithashtu janë përfshi edhe propozimet tjera të arsyeshme, përfshirë ato të parashtruara nga Projekti që e ka mbështet Sekretariatit Koordinues të Qeverisë në hartimin e koncept dokumenteve.

## **Kapitulli 8: Krahasimi i opsioneve (vlerëso pasojat e secilit opsion)**

Opsioni 1, *status quo* (asnjë ndryshim) sipas vlerësimit do të vazhdonte të mundësonte vazhdimin e pasojave negative, do të vazhdohej me zbatimin jo efikas të legjislacionit në fuqi.

Opsioni 2, miratimi i Ligjit të ri që do të rregullonte këtë fushë do të mundësonte rregullimin adekuat të fushës së lartpërmendur si dhe do të mundësonte përafrimin e legjislacionit në këtë fushë me atë të *Acquis*. Miratimi i Ligjit të ri që do të rregullonte zgjidhjen e kolizionit të ligjeve me dispozitat e shteteve të tjera, është opsioni adekuat për arritjen e këtyre synimeve dhe objektivave.

Opsioni 3, Pasojat e këtij opsioni janë tek baza referuese në dispozitat aktuale dhe do të rezultonte që akoma të vazhdojmë me legjislacionin e mëparshëm që do të vazhdoj të jetë në fuqi, mund të ketë konflikt të kompetencave midis institucioneve përgjegjëse si në rregullim poashtu edhe në implementim. Pasojë kryesore negative do të jetë e ngjashme me Opsionin 1.

## **Kapitulli 9: Rekomandimi**

Me analizën e bërë Opsioni 2 është opsioni i rekomanduar i Ministrisë së Drejtësisë, hartimi i ligjit të ri, dhe rekomandimi është që Qeveria e Republikës së Kosovës të miratoj Koncept Dokumentin për rregullimin e fushës së drejtës ndërkombëtare me qëllim që sa më parë të evitohen vështirësitë dhe pengesat që janë paraqitur gjatë zbatimit në praktikë të Ligjit për Zgjidhjen e Kolizionit të ligjeve me dispozitat e vendeve tjera në marrëdhëniet e caktuara (Fletorja Zyrtare e RSFJ, numër 43/82 dhe 78/822), këto vështirësi dhe pengesat janë paraqitur në raste që kanë të bëjnë me njohjen e vendimeve të huaja nga organet tjera kompetente administrative apo publike të shteteve të huaja. Në rast të miratimit të këtij Koncept Dokumenti, Ministria e Drejtësisë do të filloj hartimin të cilin do ta dërgoj në Qeveri për procedim të mëtejshëm.

## **Kapitulli 10: Komunikimi**

Ministria e Drejtësisë do të jetë e përqendruar në ofrimin e mundësisë akterëve relevant që të informohen lidhur me detajet e procesit të punës rreth hartimit të Projektligjit për të Drejtën Ndërkombëtare Private. Format e komunikimit do të bëhen konform Rregullores së Punës së Qeverisë. Po ashtu do të jenë përmes takimeve, grupeve punuese, takimet me grupe të interesit dhe publikimet në ueb faqe të internetit. Varësisht prej periudhës kohore në Projektligj, komunikimi do të jetë i menjëhershëm dhe shumë konstruktiv ashtu siç e parasheh legjislacioni në fuqi.